



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:088440

Datë: 24.10.2022

Numri i dokumentit: 03563291

ARJ nr. 100/2022

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Rustem Thaqi anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ të paditësve, M. G. dhe Astrit Berisha, përfaqësues të peticionit të banorëve të lagjes „A. Z., (ish T. M.), nga P..., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokat Faik Miftari nga P..., kundër të paditurës Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, (MMPHI), dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës P..., me bazë juridike anulim i vendimit të paditurit të dytë, nr.04-351/02-154837, të dt. 15.02.2022, dhe kërkesë-propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësve-propozuesve, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit- Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA. Nr. 506/2022, të datës 14.07.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 20 Tetor 2022, merr këtë :

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga e paditësit, M.G. dhe A. B., përfaqësues të peticionit të banorëve të lagjes, A. Z. (ish T. M.), nga P..., kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, në Prishtinë, AA. Nr. 506/2022, të datës 14.07.2022.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr. 506/2022, të datës 14.07.2022, refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësve-propozuesve të lartë cekur, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A nr.1062/2022, i datës 20.05.2022, vërtetohet.

Kundër aktvendimit të larë cekur të Gjykatës së Apelit, paditësit për mes përfaqësuesit sipas autorizimit avokat Faik Miftari, në afat ligjor në Gjykatë Supreme, parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën kontestojnë ligjshmërinë e

të njëjtit për shkak të; shkeljes së drejtës materiale dhe, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës që do të mund të kishin ndikim në zgjidhjen e çështjes. Propozojnë që Gjykata Supreme kërkesën ta aprovoj si të bazuar, ti ndryshoj aktvendimet e kontestuara, të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, ashtu që të aprovohet masa e përkohshme e sigurisë ,gjegjësisht të shtyhet ekzekutimi i vendimit për leje ndërtimore të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës P..., nr.04-351/02-154837 të datës 15.02.2022, gjer në marrjen e vendimit gjyqësor ,ose aktvendimet e goditura të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA mbajti seancë, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të gjykatës së shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve-propozuesve, ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa-propozimi i paditësve, me anë të së cilës kanë kërkuar që të shtyhet ekzekutimi i aktit administrativ ,vendimit të Komunës Prizren nr.04-351/02-154837 të datës 15.02.2022,derisa të merret vendimi i plotfuqishëm gjyqësor, sipas padisë së ushtruar në gjykatë lidhur me këtë çështje, si e pa bazuar.

Me nenin 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se, me kërkesën e paditësit akti i organit i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit ,i cili vështirë do të riparohej ,kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispozitën e nenit 22 paragraf 6 të njëjtit ligj përcaktohet se, paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.

Kolegji i kësaj gjykate duke e shqyrtuar kërkesën e paditësit, vendimin e atakuar të Gjykatës së Apelit dhe atë të shkallës së parë gjen se, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë si në aktvendimet e tyre të apeluara, bazuar në nenin 22 të LKA-së me refuzimin kërkesës-propozimit të paditësve nga gjykata e shkallës së parë dhe ankesës nga Gjykata e Apelit si të pa bazuara, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, nr.04-351/02-154837 të datës 15.02.2022, deri në vendosjen meritore të çështjes me vendim përfundimtar gjyqësor.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësit nuk e dëshmojë me prova bindëse në gjykatat e instancave më të ulëta dhe as tani me kërkesë se me ekzekutimin e vendimit të atakuar të organit administrativ do tu shkaktohej dëm, i cili vështirë do të riparohej kurse shtyrja nuk do të

ishte në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti shkaktonte dëm të pa riparueshëm apo të madh palës kundërshtare-kundër propozuesit, përkatësisht palës së interesuar. Në këtë çështje edhe sipas vlerësimit të kolegjit nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kushtet ligjore ashtu si parashihet në nenin 22 të Ligjit për Konflikte Administrative, që është e domosdoshme të jenë plotësuar që pastaj gjykata të nxjerrë vendim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ. Prandaj Gjykata Supreme vendos që kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësve, ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, nr. AA nr.506/2022, të datës 14.07.2022, ta refuzoj si të pa bazuar.

Pretendimet e paditësve në kërkesë si më lartë, dhe theksimet ndër të tjera në arsyetim të saj, se gjykatat e instancave më të ulëta kanë bërë shkelje të procedurës që i ka parapri marrjes së aktit të kundërligjshëm, se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, dhe vendimet janë të përfshirë me shkelje esenciale, sepse nuk janë nxjerrë edhe në kuptim të nenit 16. 1.1 dhe 1.3 të LKA, kolegji i vlerëson si jo të qëndrueshme sepse sipas këtij neni parashihen arsyet e kundërshtimit të aktit administrativ përfundimtar në procedurë gjyqësore në konflikt administrativ dhe kanë të bëjnë lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të organit të paditur, e cila shqyrtohet gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së tij sipas padisë në procedurë të rregullt. Po ashtu pretendimet e tjera procedurale se nuk janë shqyrtuar provat e propozuara si në kuptim të nenit 160.4 dhe 18.2 .n), të LPK-se, duke mos u dhënë arsye për faktet vendimtare me refuzimin e kërkesës dhe ankesës nga gjykata e shkallës së dytë ankesë, kolegji nuk i miraton, sepse nga provat e paraqitura si në shkresa të lëndës në të cilat e bazojnë kërkesën si peticioni, fotot e objektit të filluar hapja e bodrumit 2 katësh nën sipërf. e tokës, rekomandimet e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve etj., si dhe theksimeve të tjera si në kërkesë, nuk provohet se paditësve me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur, u cenohet interesi i tyre legjitim apo se atyre u shkaktohet dëm i cili vështirë do të riparohej, po ashtu nuk provohet se shtyrja nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik, ashtu si parashihet në nenin 22. 2, të LKA-së.

Aktvendimet e kontestuara të gjykatave të instancave më të ulëta, janë të drejtë dhe ligjor, të arsyetuar mjaftueshëm bazuar në faktet vendimtare të çështjes për aq sa është e domosdoshme të arsyetohet mënyra e vendosjes sipas kërkesës për masë të përkohshme, sipas provave të ofruara nga paditësit, gjithnjë duke u kujdesur gjykata që mënyra e vendosjes për masë të përkohshme dhe arsyetimi i vendimmarrjes të mos prejudiojë mënyrën e vendosjes së çështjes kryesore. Prandaj pretendimet në këtë drejtim se, vendimet e kontestuara të instancave më të ulëta gjyqësore, nuk janë të arsyetuar ligjërisht dhe nuk janë vlerësuar provat në shkresa të lëndës në bazë të cilave vërtetohet se i plotësojnë kushtet ligjore për tu shtyrë ekzekutimi i vendimit të organit të paditur, nuk janë të qëndrueshme dhe me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje nga ajo e vendosur si në vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta, të cilët janë të qartë dhe të arsyetuar mjaftueshëm ligjërisht për të gjitha faktet vendimtare si parashihet në nenin 22 të LKA-së.

Numri i lëndës: 2022:088440

Datë: 24.10.2022

Numri i dokumentit: 03563291

Nga arsyet e paraqitura si më lartë dhe në bazë të nenit 54, par.1, lidhur me nenin 22, par.2 dhe 6, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ nr. 100/2022, me datë 20 Tetor 2022

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani